

**PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL
PËR MARRJEN E KATEGORIVE
TË KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE
TË LËNDËS "GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI"**



Program orientues

**Koordinator:
Erida Koleci**

2025-2026

TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES.....	1
HYRJE	2
QËLLIMET E PROGRAMIT	4
PËRMBAJTJA E PROGRAMIT.....	6
Përmbajtja e programit orientues për testimin e informatizuar	7
Modele pyetjesh për AMU-në dhe për AML-në	17
Modele pyetjesh në “Gjuhë shqipe dhe letërsi” AML.....	24
Përmbajtja e programit orientues për orën e hapur mësimore.....	31
Model ore mësimore për secilin nivel (AMU dhe AML).....	32
Kriteret e vlerësimit të orës mësimore.....	45
Përmbajtja e programit orientues për projektin kurrikular	51
Modele të projekteve kurrikulare për nxënësit në AMU dhe AML	53
Kriteret e vlerësimit të projekteve kurrikulare për nxënësit në AMU dhe AML	59

HYRJE


Mësuesi i gjuhës shqipe dhe i letërsisë nuk është thjesht një mësues që transmeton njohuri, por është një udhërrëfyes që ndikon thellë në formimin e identitetit të nxënësve të tij. Në çdo fjali që thotë, në çdo tekst që lexon dhe analizon me nxënësit, ai mban gjallë një pjesë të trashëgimisë së gjuhës dhe të kulturës shqiptare.

Nxënësit e tij janë në një fazë të rëndësishme të jetës, gjatë së cilës çdo ditë mësojnë diçka të re dhe formësojnë botëkuptimin e tyre. Në këtë udhëtim, mësuesi i gjuhës shqipe luan një rol kyç. Me pasionin e tij për gjuhën, ai i ndihmon ata të kuptojnë thelbin e komunikimit të saktë dhe të bukur në gjuhën shqipe. Përmes fjalëve, ai mbjell dashurinë për gjuhën shqipe në zemrat e tyre, duke u treguar se si një fjalë e thjeshtë mund të mbartë në vetvete histori, emocione dhe traditë.

Në orën e letërsisë, klasa transformohet në një hapësirë magjike ku personazhet e veprave marrin jetë, konfliktet ndërtohen dhe zgjidhen dhe nxënësit udhëtojnë nëpër kohë dhe vende të ndryshme. Mësuesi nuk i udhëheq vetëm në rrugët e thjeshta të rrëfimit, por i sfidon të mendojnë thellë, të analizojnë veprimet dhe motivet e personazheve, të kuptojnë dhe reflektojnë mbi mesazhet e fshehura në letërsi. Aty, në heshtjen e klasës, ndërsa lexojnë një poezi të Lasgush Poradecit ose një prozë të Kadaresë, nxënësit ndjejnë se janë pjesë e diçkaje më të madhe – pjesë e një trashëgimie që i lidh me të kaluarën dhe i frymëzon për të ardhmen.

Në çdo moment, mësuesi i gjuhës shqipe dhe i letërsisë është një mentor që përkujdeset për zhvillimin personal të nxënësve të tij. Ai përdor letërsinë për t'i frymëzuar, për t'i sfiduar mendërisht dhe emocionalisht nxënësit. Përmes teksteve letrare dhe jo letrare që lexojnë, ata përballen me çështje të rëndësishme të jetës, si: drejtësia, dashuria, sakrifica dhe ndershmëria. Dhe në këtë proces, mësuesi është aty për t'i ndihmuar ata të kuptojnë se çfarë do të thotë të jesh një qytetar i përgjegjshëm, i ndjeshëm dhe i lidhur ngushtë me rrënjët kulturore.

Në fund të çdo dite shkollore, mësuesi largohet me një ndjenjë përmbushjeje. Ai e di që ka dhënë më shumë se disa orë mësimore të zakonshme: ai ka mbjellë farën e dashurisë për gjuhën, letërsinë dhe identitetin kombëtar tek brezi i ri. Dhe për këtë, misioni i tij mbetet i një rëndësie të jashtëzakonshme në jetën e çdo nxënësi. Për ta përmbushur këtë mision kaq të rëndësishëm,



zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësuesit të gjuhës shqipe dhe të letërsisë është i domosdoshëm.

Zhvillimi i vazhdueshëm profesional siguron që mësuesit të jenë gjithmonë të përditësuar me praktikën më të reja të mësimdhënies dhe me zhvillimet e fundit në fushën e gjuhësisë dhe të letërsisë, duke garantuar që të ofrojnë proces mësimor cilësor. Pjesë e këtij procesi është edhe marrja e kategorive të kualifikimit. Kualifikimi është një proces nëpërmjet të cilit mësuesi certifikohet jo vetëm për të dëshmuar arritjet e tij profesionale, por edhe për të avancuar në karrierë. Për të orientuar mësuesit për këtë proces është hartuar programi i zhvillimit profesional për marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve gjuhës shqipe dhe të letërsisë. Ky program është hartuar nga një grup pune, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), dhe në përmbushje të kërkesave që MAS-i ka vendosur për mësuesit që kualifikohen.

Procesi i kualifikimit:

- për kandidatët e kategorisë “*Mësues i kualifikuar*”, realizohet nëpërmjet vlerësimit:
 - të dosjes së zhvillimit profesional,
 - të orës së hapur mësimore,
 - me test të informatizuar sipas lëndëve/profileve dhe niveleve përkatëse.
- për kandidatët e kategorisë “*Mësues specialist*”, realizohet nëpërmjet vlerësimit:
 - të dosjes së zhvillimit profesional të mësuesve,
 - të orës së hapur mësimore,
 - të projektit kurrikular në lëndën/profilin dhe nivelin përkatës.
- për kandidatët e kategorisë “*Mësues mjeshër*”, realizohet nëpërmjet vlerësimit:
 - të dosjes së zhvillimit profesional të mësuesve,
 - të projektit kurrikular në lëndën/profilin dhe nivelin përkatës.


QËLLIMET E PROGRAMIT

Programi i zhvillimit profesional për marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve të gjuhës shqipe dhe të letërsisë është hartuar për t'u ardhur në ndihmë:

- mësuesve të gjuhës shqipe dhe të letërsisë për zhvillimin e tyre profesional dhe për marrjen e kategorive të kualifikimit, si dhe për të përballuar me sukses kërkesat që ka ky proces kombëtar.
- Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) dhe Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) për të organizuar zhvillimin profesional për të gjithë mësuesit që do të hyjnë në procesin e kualifikimit.

Programi ka për qëllim që mësuesi:

- të njohë dhe të zbatojë rrishtë më të fundit në sistemin arsimor parauniversitar, për të përmirësuar procesin e të nxënës dhe të mësimdhënies.
- të zotërojë njohuri dhe aftësi, duke bazuar në standardet profesionale të mësuesit, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor dhe për të arritur rezultate të suksesshme në klasë.
- të demonstrojë aftësi në fushën pedagogjike për përzgjedhjen e modeleve të organizimit të mjedisit të klasës, shtjellimin e koncepteve, zhvillimin e mendimit kritik dhe krijues, nxitjen e diskutimeve, përdorimin e metodave të përshtatshme me stilet e të nxënës, përdorimin e teknikave të vlerësimit të nxënësve, përdorimin e aftësive digjitale në procesin mësimor përfshirë edhe inteligjencën artificiale.
- të tregojë përgjegjshmëri në njohjen e koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës/ve, duke i zbatuar në praktikë dhe në jetën e përditshme, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasave ku jep mësim.
- të vlerësojë dhe të integrojë diversitetin kulturor dhe gjuhësor në klasë, duke krijuar një mjedis gjithëpërfshirës që nxit ndjenjën e përkatësisë për të gjithë nxënës.
- të lidhë dhe të aktualizojë konceptet lëndore me çështjet globale që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike, fatkeqësitë natyrore, pandemitë, krizat ekonomike, barazinë gjinore, sigurinë kibernetike etj., për të ndërgjegjësuar nxënës dhe për t'i përgatitur ata për sfidat e shoqërisë së sotme dhe të së ardhmes.

- 
- të zbatojë rregullat e etikës dhe të komunikimit në shkollë, duke krijuar një atmosferë që karakterizohet nga respekti dhe bashkëpunimi.
 - të përdorë saktë drejtshkrimin e gjuhës shqipe gjatë procesit të mësimdhënies dhe të nxënies.
 - të zotërojnë aftësitë e TIK-ut në procesin mësimor, duke i integruar si pjesë e metodave të reja të mësimdhënies dhe të modeleve të arsimit të kombinuar.
 - të planifikojë dhe të zhvillojë orë mësimi efektive sipas metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe të të nxënës.
 - të planifikojë dhe të zhvillojë projekte, të cilat zhvillojnë kompetencat e nxënës.

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Përmbajtja e programit orientues të kualifikimit të mësuesve është e organizuar në tre kapituj, si më poshtë:

3.1 Përmbajtja e programit orientues për testimin e informatizuar. Në këtë rubrikë përfshihen kompetencat profesionale dhe rezultatet e pritshme sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional për realizimin e testit të informatizuar, si edhe modele pyetjesh për gjuhën shqipe në arsimin e mesëm të ulët (AMU), si dhe për gjuhën shqipe dhe letërsinë në arsimin e mesëm të lartë (AML).

3.2 Përmbajtja e programit orientues për orën e hapur mësimore. Në këtë rubrikë përfshihen kompetencat profesionale për organizimin e orës së hapur mësimore, dy modele orësh mësimore për gjuhën shqipe dhe për letërsinë në AMU dhe në AML, si dhe kriteret e vlerësimit të orës së hapur mësimore.

3.3 Përmbajtja e programit orientues për projektin kurrikular. Në këtë rubrikë përfshihen kompetencat profesionale për zhvillimin e projektit kurrikular, dy modele projektsh kurrikulare për gjuhën shqipe dhe letërsinë në AMU dhe AML, si dhe kriteret e vlerësimit të projektit kurrikular.

Përmbajtja e programit orientues për testimin e informatizuar

Testi i informatizuar i procesit të kualifikimit përbëhet nga dy pjesë:

- a) Pjesa e parë përmban pyetje dhe kërkesa rreth programeve lëndore, planifikimit të lëndës, mjedisit të të nxënës, metodologjive efektive të mësimdhënie – nxënies, vlerësimit dhe arritjeve të nxënësve, etikës dhe komunikimit të mësuesit në institucionin arsimor parauniversitar, si dhe rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- b) Pjesa e dytë përfshin pyetje dhe kërkesa të niveleve të ndryshme rreth përmbajtjes shkencore të lëndës/ve.

Programi i testimit të informatizuar është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve janë:

- Programet e gjuhës shqipe dhe të letërsisë.
- Aspektet e pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të TIK-ut në procesin e mësimdhënies dhe të nxënës të gjuhës shqipe dhe të letërsisë.
- Aspektet e etikës dhe të komunikimit.
- Aspektet e drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- Përmbajtjen shkencore të gjuhës shqipe dhe të letërsisë, sipas programeve mësimore lëndore.

Në fushat kryesore të zhvillimit profesional përcaktohen:

- kompetencat profesionale dhe rezultatet e pritshme për realizimin e këtyre kompetencave;
- literatura përkatëse rekomanduese në funksion të përvetësimit të kompetencave të gjuhës shqipe dhe të letërsisë.

Rezultatet e pritshme dhe literatura e rekomanduar për çdo fushë të zhvillimit profesional do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

FUSHA “PROGRAMET LËNDORE TË GJUHËS SHQIPE DHE TË LETËRSISË”

Kompetenca: Zbatimi në mënyrë efektive i programeve të gjuhës shqipe të dhe letërsisë në shkollë.

Literatura e rekomanduar

Rezultatet e pritshme

Mësuesi:

- zbaton programet lëndore duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tyre;
- përshtat programet lëndore në përputhje me karakteristikat e zhvillimit moshor të nxënësve dhe me veçoritë e mjedisit në të cilin jep mësim;
- planifikon orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin;
- përdor fleksibilitetin në zbatimin e programeve lëndore, duke i përshtatur ato sipas prirjeve bashkëkohore;
- gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që i ndihmojnë nxënësit në përvetësimin e koncepteve dhe të aftësive të përcaktuara në programet mësimore;
- gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që pasurojnë njohuritë e nxënësve, si dhe nxitin mendimin e pavarur, kritik dhe krijues të tyre;

- Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar.
- Kurrikula bërthamë AMU, klasat VI-IX.
- Kurrikula bërthamë AML, klasat X-XII.
- Programet lëndore të bazuara në kompetenca, për klasat 6-9, lënda “Gjuhë shqipe”.
- Programet lëndore të bazuara në kompetenca, për klasat 10-12, lëndët “Gjuhë shqipe”, “Letërsi” dhe “Letërsi me zgjedhje”.

- njeh dhe zbaton koherencën vertikale të programeve të gjuhës shqipe dhe të letërsisë;
- harton rezultate të nxëni për tema mësimore ose grupe temash që janë në përputhje me programet mësimore lëndore;
- për zgjedh metodat, teknikat, veprimtaritë dhe mjetet mësimore të nevojshme për të mundur përmbushjen e rezultateve të nxënit;
- përcakton nivelet e vlerësimit të nxënësve duke u bazuar në rezultatet e nxënit dhe në nivelet e arritjes të kompetencave lëndore;
- siguron informacion që demonstroi lidhjen e gjuhës me letërsinë, me shkencat e tjera dhe me jetën reale.

FUSHA “ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK -UT NË MËSIMDHËNIE”

Kompetenca 1: Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien e gjuhës shqipe dhe të letërsisë.

Literatura e rekomanduar

Rezultatet e pritshme

Mësuesi:

- Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS.
- Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së gjuhës shqipe në arsimin e mesëm të ulët.

- tregon përkushtim të vazhdueshëm, motivim dhe ndjenjë të lartë përgjegjësie gjatë punës së tij; - përshtat metodat dhe teknikat mësimore sipas zhvillimit njohës, social dhe emocional të nxënësve, duke marrë parasysh dallimet individuale dhe fazat e tyre të rritjes; - përdor metoda, teknika dhe strategji mësimore që synojnë përfshirjen e plotë të të gjithë nxënësve në procesin e të nxënësve; - identifikon nxënësit me nevoja të veçanta dhe harton plane të veçanta, për të siguruar përfshirjen e tyre në mësim; - shfaq qëndrim pozitiv dhe përkushtim në mësimdhënien e gjuhës shqipe dhe letërsisë, duke qenë një shembull për nxënësit; - ndërton marrëdhënie të bazuara në respekt, besim dhe objektivitet me nxënësit, duke krijuar një mjedis mbështetës dhe të sigurt për të gjithë; - ushqen te nxënësit dashurinë për gjuhën shqipe dhe letërsinë, duke nxitur kërshëri, pasion dhe dëshirë për të mësuar më shumë; - motivon nxënësit duke e trajtuar motivimin si një element të domosdoshëm për progresin e tyre, si dhe përdor teknika për të nxitur vetëbesimin dhe qëndrueshmërinë;	- Udhëzuesi për zhvillimin e gjuhës shqipe dhe të letërsisë në arsimin e mesëm të lartë.
---	--

- krijon një atmosferë pozitive, inkurajuese dhe të këndshme në klasë, duke nxitur pjesëmarrjen aktive dhe bashkëpunimin mes nxënësve.

Kompetenca 2: Përdorimi i metodave dhe i strategjive efektive në mësimdhënien e gjuhës shqipe dhe të letërsisë.

Literatura e rekomanduar

Rezultatet e pritshme

Mësuesi:

- përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e rezultateve të të nxënit;
- nxit zhvillimin e mendimit kritik dhe të pavarur te nxënësit, duke përdorur teknika që i ndihmojnë ata të analizojnë dhe të interpretojnë me vetëbesim tekstet letrare dhe ato jo letrare;
- planifikon dhe zhvillon orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin;
- përdor metoda e teknika që ndikojnë në ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave kyç dhe të kompetencave lëndore;
- përdor metoda dhe teknika të ndryshme mësimore që përkojnë me stilet e ndryshme të të nxënit;

- Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), ASCAP.
- Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së gjuhës shqipe në arsimin e mesëm të ulët.
- Udhëzuesi për zhvillimin e gjuhës shqipe dhe të letërsisë në arsimin e mesëm të lartë.
- Modele testesh për arsimin parauniversitar (Teste të hartuara nga mësuesit), ASCAP.
- Modele pyetjesh nga mësuesit për mësuesit, ASCAP. *Lënda:* Gjuhë shqipe dhe Letërsi.

- njeh dhe zbaton gjatë procesit të të nxënësve lloje të ndryshme të vlerësimit; - vlerëson nxënësit duke u bazuar në nivelet e arritjeve; - përdor teknika dhe evidenca të ndryshme për vlerësimin e nxënësit; - zhvillon me nxënësi teste që zbatojnë parimet e hartimit dhe të pikëzimit të një testi; - reflekton dhe përmirëson vazhdimisht qasjet e veta pedagogjike në përputhje me rritjen në fushën e arsimit dhe me kërkesat e kohës, për të ofruar mësimdhënie të cilësisë së lartë.	
Kompetenca 3: Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies/nxënies së gjuhës shqipe dhe të letërsisë.	
Rezultatet e pritshme Mësuesi: - nxit dhe udhëzon nxënësit të krijojnë dhe prezantojnë materiale/çështje të ndryshme gjatë orës mësimore duke përdorur mjete të TIK-ut; - kërkon dhe përzgjedh materiale nga burime të besueshme në internet për të pasuruar përmbajtjen mësimore;	Literatura e rekomanduar - Standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe të Komunikimit. - Materiali ndihmës për mësuesit lidhur me përdorimin e platformave online në procesin mësimor, ASCAP.

- përdor platforma të ndryshme online dhe aplikacione mësimore për të zhvilluar një proces mësimor më ndërveprues dhe për të përfituar nga format bashkëkohore të mësimdhënies; - përfshin nxënësit në projekte lëndore dhe në veprimtari që kombinojnë kërkimin dhe përdorimin e burimeve në internet, duke i ndihmuar ata të zhvillojnë aftësitë për hulumtim, analizë dhe prezantim të informacionit; - realizon teste dhe vlerësime përmes platformave online për të ndihmuar në matjen e progresit dhe arritjeve të nxënësve në kohë reale.	
--	--

FUSHA “ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT”

Kompetenca: Zbatimi i rregullave të etikës dhe të komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit.

Literatura e rekomanduar

Rezultatet e pritshme Mësuesi: - njeh dhe zbaton rregullat e etikës dhe të sjelljes profesionale në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, kolegët, nxënësit, prindërit dhe komunitetin;	- Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar. - Rregullorja e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë. - Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të
---	--

- përçon mesazhe në mënyrë profesionale dhe të përshtatshme, duke përdorur gjuhë të qartë, pozitive dhe të kuptueshme; - merr parasysh ndjeshmërinë kulturore dhe respektin për diversitetin, duke i trajtuar të gjithë individët me integritet dhe me ndershmëri; - respekton konfidencialitetin dhe privatësinë e të dhënave të nxënësve dhe kolegëve, duke zbatuar praktikat etike të përpunimit dhe të ruajtjes së informacionit; - ndihmon në krijimin e një klime bashkëpunuese dhe të mbështetur në respekt dhe mirëkuptim në institucionin arsimor; - zgjidh në mënyrë etike dhe konstruktive situatat e vështira dhe mosmarrëveshjet, duke ndjekur parimet e drejtësisë dhe të objektivitetit.	mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar.
---	--

FUSHA “ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE”

Kompetenca: Zbatimi i rregullave drejtshkrimore të gjuhës shqipe.

Literatura e rekomanduar

Rezultatet e pritshme

Mësuesi:

- zbaton rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe në mënyrë të saktë dhe të përpiktë, duke siguruar që të gjitha materialet mësimore dhe komunikimi me nxënësit të jenë të shkruar në përputhje me këto rregulla;
- vlerëson rëndësinë e përdorimit të gjuhës standarde në të gjitha veprimtaritë dhe punët e tij;
- përdor TIK-un për respektimin e rregullave të drejtshkrimit, si p.sh., programe korrigjimi drejtshkrimor.

- Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.

FUSHA “PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS”

Kompetenca: Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien e lëndës së gjuhës shqipe dhe të letërsisë.

Literatura e rekomanduar

Rezultatet e pritshme

Mësuesi:

- analizon dhe formulon gjykime kritike për letërsinë shqipe e botërore, për periudhat dhe drejtimet letrare, si dhe për

- Programe dhe tekste të lëndës së gjuhës shqipe, të letërsisë dhe të letërsisë me zgjedhje, për nxënësin dhe për mësuesin, si dhe materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen lëndore për klasat 6-9 për arsimin e mesëm të ulët, si dhe

shkrimtarët përfaqësues dhe krijimtarinë e tyre letrare; - kupton, interpreton, analizon dhe vlerëson tekste e fragmente të ndryshme letrare dhe jo letrare; - shkruan ese me tematika që lidhen me çështje të ndryshme arsimore; - analizon dhe vlerëson tiparet e stilit dhe të gjuhës në një tekst ose fragment; - kryen analiza të sakta dhe të strukturuar të sistemit gjuhësor të shqipes, duke përfshirë morfologjinë, sintaksën dhe leksikologjinë, si dhe demonstroi aftësi për t'i shpjeguar ato në mënyrë të qartë; - respekton dhe përçon tek nxënësit rëndësinë e rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit në komunikimin formal dhe në jetën e përditshme; - motivon dhe mbështet nxënësit në zhvillimin e mendimit kritik për letërsinë dhe gjuhën shqipe, duke nxitur reflektimin mbi lidhjet mes letërsisë, gjuhës dhe realitetit shoqëror.	për klasat 10 - 12 për arsimin e mesëm të lartë.
---	---

Modele pyetjesh për AMU-në dhe për AML-në

Modele pyetjesh “Gjuhë shqipe”, AMU

Programi lëndor

Pyetja 1

Programi i lëndës së gjuhës shqipe bazohet në parimin se:

- A) jo të gjithë nxënësit kanë mundësi që të arrijnë rezultate të mira dhe të jenë të suksesshëm.
- B) të gjithë nxënësit kanë mundësi që të arrijnë rezultate të mira dhe të jenë të suksesshëm.
- C) vetëm nxënësit që e kanë shqipen gjuhë amtare, kanë mundësi që të arrijnë rezultate të mira dhe të jenë të suksesshëm.
- D) vetëm nxënësit që janë bilingualë, kanë mundësi që të arrijnë rezultate të mira dhe të jenë të suksesshëm.

Pyetja 2

Temat ndërkurrikulare janë:

- A) çështje të rëndësishme me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen dhe që trajtohen në fushat e të nxënës duke krijuar mundësinë që nxënësit të interpretojnë botën dhe të lidhin dijet e marra në shkollë me jetën dhe me interesat e tyre.
- B) një bashkësi lëndësh që kanë qëllime dhe detyra të përbashkëta për formimin e njohurive të reja dhe të kompetencave të nxënësve.
- C) tërësia e dijeve, informacionit, fakteve, situatave, veprimtarive etj., të grupuara në një lëndë ose fushë të nxënës, që shërbejnë si bazë për formimin dhe zhvillimin e njohurive të reja dhe kompetencave kyç.
- D) veprimtari themelore të institucioneve arsimore që sigurojnë krijimin dhe shndërrimin e njohurive, përsosjen e kompetencave gjatë gjithë jetës dhe zhvillimin vetjak.



Aspekte të pedagogjisë dhe të metodologjisë

Pyetja 3

Cila nga teknikat e mëposhtme zhvillon aftësinë e nxënësve për të identifikuar shkaqet dhe pasojat e një problemi?

- A) Diagrami i Venit
- B) Leximi i drejtuar
- C) Pema e problemit
- D) Rrjeti i diskutimit

Pyetja 4

Cila nga teknikat e mëposhtme është më efektive në zhvillimin e aftësive të nxënësve për të analizuar dhe për të kategorizuar informacione të ndryshme?

- A) Diagrami i Venit
- B) Harta e konceptit
- C) Harta e mendjes
- D) Stuhi mendimi

Pyetja 5

Cila nga alternativat e mëposhtme NUK është rubrikë e planit të periudhës?

- A) Burimet e të nxënit
- B) Integrimi i lëndës me lëndët e tjera
- C) Tema mësimore
- D) Vlerësimi i nxënësve

Pyetja 6

Cili nga pohimet e mëposhtme është tipar i planifikimit së mësimdhënies që zhvillon kompetenca?

- A) Në planifikim përcaktohet se çfarë do të bëjnë nxënësit gjatë procesit mësimor.
- B) Në planifikim përcaktohet çfarë do të bëjë mësuesi për të realizuar mësimin.
- C) Në planifikim, roli i mësuesit është kryesisht ligjërues (shpjegon).
- D) Planifikimi i mësimit përqendrohet pothuajse te njohuritë lëndore.

Pyetja 7

Gjatë orëve të mësimit për zhvillimin e aftësive të të shkruarit, mësuesi jep komente për çdo nxënës lidhur me stilin dhe strukturën e punës me shkrim, para se ata të dorëzojnë versionin final. Ç' lloj vlerësimi po përdor mësuesi?

- A) Vlerësimi i të nxënësit
- B) Vlerësimi për të nxënë
- C) Vlerësimi diagnostikues
- D) Vlerësimi me dosje

Pyetja 8

Mësuesi prezanton një temë dhe kërkon që çdo nxënës të shkruajë një fjalim, të cilin do ta prezantojnë para klasës. Cila aftësi e nxënësve po zhvillohet në këtë rast?

- A) Aftësia për të identifikuar temën kryesore në një fjalim
- B) Aftësia për të lexuar me zë të lartë
- C) Aftësia për të organizuar dhe për të prezantuar mendimet në mënyrë të qartë
- D) Aftësia për të përmbledhur tekste joletrare

Aspekte të komunikimit dhe të etikës

Pyetja 9

Mësuesi ka planifikuar një vizitë me nxënësit në bibliotekën e qytetit. Çfarë është më efektive të bëjë mësuesi, në mënyrë që edhe Joni, një fëmijë që lëviz me anë të karrocës, ta vizitojë bibliotekën?

- A) Mësuesja i kërkon një mësuesi tjetër për ta shoqëruar Jonin në këtë vizitë.
- B) Mësuesja shkon më parë në bibliotekë dhe evidenton problemet me të cilat mund të ndeshet nxënësi i saj dhe bën një planifikim paraprak.
- C) Mësuesja i kërkon Jonit të vijë i shoqëruar me një pjesëtar të familjes, i cili do ta shoqërojë atë.
- D) Mësuesja e inkurajon dhe i kërkon Jonit të qëndrojë në shtëpi ditën e vizitës.

Pyetja 10

Për fëmijët me aftësi të kufizuara në klasat e zakonshme, mësuesi ndihmës bën vlerësimin sipas niveleve të arritjeve të fushave të zhvillimit të përcaktuara në PEI. Ky vlerësim duhet bërë në bashkëpunim:

- A) me drejtuesin e institucionit arsimor dhe specialistë të patologjisë/ve që shfaq fëmija.
- B) me mësuesin e lëndës dhe shërbimin psiko-social të institucionit arsimor.
- C) me prindin dhe kujdestarët që kujdesen për fëmijën.
- D) me komisionin multidisiplinar të ngritur pranë ZVAP-së.

Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe

Pyetja 11

Cila nga fjalitë e mëposhtme NUK është shkruar saktë?

- A) Olimpiada zhvillohet sipas procedurave të përcaktuara në një udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.
- B) Pas këtij njoftimi, drejtori i shkollës bën çregjistrimin e nxënësit.
- C) Të gjithë nxënësit pajisen me certifikatë dhe diplomë të Maturës Shtetërore.
- D) Vlerësimi është procesi gjatë të cilit mbledhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së rezultateve të të nxënësit.

Pyetja 12

Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë?

- A) Mbrojtja dhe përpunimi i të dhënave personale të nxënësve bëhet në përputhje me Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
- B) Mbrojtja dhe përpunimi i të dhënave personale të nxënësve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9887, Datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- C) Mbrojtja dhe përpunimi i të dhënave personale të nxënësve bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- D) Mbrojtja dhe përpunimi i të dhënave personale të nxënësve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Përmbajtja shkencore e lëndës

Pyetja 13

Dokumenti i parë i shqipes së shkruar që daton vitin 1462, është:

- A) Formula e Pagëzimit.
- B) Meshari i Gjon Buzukut.
- C) Fjalori i Arnold fon Harfit.
- D) Perikopeja e Ungjillit të Pashkës.

Pyetja 14

Fjala “kurrfarë” në fjalinë: “*Bardha nuk bëri kurrfarë lëvizjeje*” është:

- A) ndajfolje mënyre.
- B) ndajfolje sasie.
- C) përemër i pacaktuar.
- D) përemër dëftor.

Pyetja 15

Në cilën nga alternativat kemi shprehje frazeologjike?

- A) Mendje e madhe, e zeza e të zot.
- B) Nuk e ka mendjen në vend.
- C) Mendjet e kombit shpallën pavarësinë.
- D) Mendo shtatë herë e prit një herë.

Pyetja 16

Cili është funksioni sintaksor i “*prej mallit*” në vargun: “*E prej mallit derdhi lot*”?

- A) Kundrinor i zhdrejtë me parafjalë
- B) Përcaktor kallëzuesor
- C) Rrethanor qëllimi
- D) Rrethanor shkaku

Pyetja 17

Në vargjet: “*Molla t’këputuna një degët/ dy qershia lidhë n’nji rrfanë/ ku fillojnë kufijt e Geget/ rrinë dy çika me një nanë*”, janë përdorur:

- A) metafora emra;
- B) metafora folje;
- C) metafora mbiemra;
- D) metafora ndajfolje.

Pyetja 18

Si quhet një poezi që i kushtohet diçkaje hyjnore dhe që dallohet për tonin solemn dhe ritmin e ngadalshëm?

- A) Elegji
- B) Himn
- C) Oda
- D) Sonet

Pyetja 19

Si do të ndryshonte një tekst nëse qëllimi i autorit të fjalimit është të përfshijë emocionalisht lexuesin:

- A) Të shkruhet në vetë të tretë me sa më shumë fakte dhe ilustrime.
- B) Të shkruhet në kohën e ardhme të mënyrës dëftore.
- C) Të shkruhet në vetën e parë njëjës ose shumës.
- D) Të shpjegojë rëndësinë e problemit që trajtohet në atë tekst.

Pyetja 20

Figura letrare me të cilën Naimi krijon përfytyrimin e natyrës shqiptare në hyrje të poemës “Bagëti dhe bujqësi”, është :

- A) enumeracioni.
- B) metonimia.
- C) paralelizmi figurativ.
- D) simboli.

Modele pyetjesh në “Gjuhë shqipe dhe letërsi” AML

Programi lëndor

Pyetja 1

Kompetencat kyç janë:

- A) kapacitete (mendore ose fizike) të fituara për të arritur rezultatet e parashikuara, shpesh me shpenzim minimal të kohës ose të energjisë ose të të dyjave;
- B) njohuri, aftësi, vlera dhe qëndrime për të cilat kanë nevojë të gjithë individët për plotësim dhe zhvillim vetjak, për qytetari aktive, për përfshirje sociale dhe për punësim;
- C) tema madhore me të cilat përballet shoqëria dhe që zhvillohen nëpërmjet fushave të të nxënës;
- D) tërësia e dijeve, informacionit, fakteve, situatave, veprimtarive etj., të grupuara në një lëndë ose fushë të nxënësi që shërbejnë si bazë për formimin dhe zhvillimin e njohurive të reja.

Pyetja 2

Rezultati i të nxënës “*Nxënësi analizon tiparet kryesore të romantizmit dhe të realizmit, periudhën historike në të cilën u zhvilluan këto drejtime letrare, gjinitë dhe llojet letrare që u lëvruan, si dhe veprat e autorëve më përfaqësues.*”, është:

- A) në lëndën e letërsisë bërthamë në klasën X.
- B) në lëndën e letërsisë bërthamë në klasën XI.
- C) në lëndën e letërsisë bërthamë në klasën XII.
- D) në lëndën e letërsisë me zgjedhje në klasën XII.

Aspekte të pedagogjisë dhe të metodologjisë

Pyetja 3

Çfarë nënkuptohet me mësimdhënie të diferencuar?

- A) Mësim i njëjtë për të gjithë nxënësit
- B) Përshtatja e mësimdhënies sipas nevojave dhe niveleve të nxënësve
- C) Vlerësimi i të gjithë nxënësve në të njëjtin nivel
- D) Zhvillimi i testeve dhe i detyrave të njëjta për të gjithë nxënësit

Pyetja 4

Rrjeti i diskutimit është një teknikë mësimore, e cila:

- A) bazohet mbi një mjet pamor që shërben për të paraqitur informacione, ide, koncepte, si dhe lidhjet mes tyre në një mënyrë të organizuar.
- B) i nxit nxënësit të lexojnë dhe të parashikojnë rreth brendisë së një teksti.
- C) ndërtohet mbi bazën e një pyetjeje të hapur që pranon si përgjigje pozitive, ashtu edhe përgjigje negative.
- D) përdoret që nxënësit të kujtojnë terma, fakte, njohuri ose ngjarje për një temë ose një grup temash mësimore.

Pyetja 5

Cila nga teknikat e mëposhtme është më efektive në zhvillimin e aftësisë së nxënësve për të aktivizuar njohuritë e mëparshme?

- A) Diagrami i Venit
- B) Pema e problemit
- C) Rrjeti i diskutimit
- D) Stuhi mendimi

Pyetja 6

Vlerësimi përfundimtar përmbledh notat vjetore si më poshtë:

- A) Notën vjetore të vlerësimit të vazhduar për dy periudhat, notën vjetore të vlerësimit me test/detyrë përmbledhëse për dy periudhat dhe notën e vlerësimit të projektit.
- B) Notën vjetore të vlerësimit të vazhduar për katër periudhat, notën vjetore të vlerësimit me test/detyrë përmbledhëse për katër periudhat dhe notën e vlerësimit të projektit.
- C) Notën vjetore të vlerësimit të vazhduar për tri periudhat, notën vjetore të vlerësimit me test/detyrë përmbledhëse për tri periudhat dhe notën e vlerësimit të projekteve për tri periudhat.
- D) Notën vjetore të vlerësimit të vazhduar për tri periudhat, notën vjetore të vlerësimit me test/detyrë përmbledhëse për tri periudhat dhe notën e vlerësimit të projektit.

Pyetja 7

Në fillim të vitit shkollor, mësuesi duhet të dorëzojë në drejtorinë së shkollës:

- A) plani vjetor të lëndës dhe planin ditor.
- B) planin e periudhës së parë dhe planet ditore.
- C) planin vjetor të lëndës dhe planin e periudhës së parë.
- D) planin vjetor të lëndës dhe planin e tri periudhave.

Pyetja 8

Cili nga pohimet e mëposhtme NUK është tipar i planifikimit të mësimdhënies që zhvillon kompetenca?

- A) Planifikimi i mësimi përqendrohet mbi proceset, veprimtaritë ose situatat e të nxënit.
- B) Në planifikim përcaktohet se çfarë do të bëjnë nxënësit gjatë procesit mësimor.
- C) Në planifikim përcaktohet çfarë do të bëjë mësuesi për të realizuar mësimin.
- D) Planifikimi i mësimi nuk ka gjithmonë të njëjtën metodologji, pasi organizimi varet nga rezultatet e të nxënit të orës mësimore.

Aspekte të komunikimit dhe të etikës

Pyetja 9

Në një klasë ku ka nxënës me vështirësi në të nxënë, mësuesi:

- A) vendos të njëjtat rezultate të nxëni për të gjithë nxënësit e klasës, por realizon punë të diferencuar me nxënës të ndryshëm;
- B) përqendron punën dhe fokusohet vetëm te nxënësit me nivel më të ulët arritjesh;
- C) vendos rezultate të nxëni të ndryshme për nxënës të ndryshëm;
- D) përqendron punën dhe fokusohet vetëm te nxënësit me nivel të lartë arritjesh.

Pyetja 10

Procesi i gjithëpërfshirjes fillon me:

- A) nxitjen e diferencave mes nxënësve.
- B) njohjen dhe pranimin e diferencave mes nxënësve.
- C) zhvillimin e të drejtave të nxënësve.
- D) thellimin e diferencave mes nxënësve.

Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe

Pyetja 11

Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë?

- A) Pranimet në shkollat e arsimit të mesëm të orientuar bëhen sipas përcaktimeve të udhëzimit përkatës të ministrit.
- B) Pranimet në shkollat e arsimit të mesëm të orientuar bëhen sipas përcaktimeve të Udhëzimit përkatës të Ministrit.
- C) Pranimet në shkollat e Arsimit të Mesëm të Orientuar bëhen sipas përcaktimeve të Udhëzimit përkatës të Ministrit.
- D) Pranimet në shkollat e Arsimit të Mesëm të Orientuar bëhen sipas përcaktimeve të udhëzimit përkatës të ministrit.

Pyetja 12

Cila nga fjalitë e mëposhtme është shkruar saktë?

- A) Drejtori i shkollës dërguese, pas njoftimit, bën ç’regjistrimin e nxënësit.
- B) Institucionet arsimore private përcaktojnë në rregulloren e tyre të brendshme, procedurat e çdëmtimeve.
- C) Institucioni arsimor ruan në një vend të posaçëm trofetë që ka fituar në veprimtari të ndryshme.
- D) Mësuesi kujdestar përkujdeset posaçërisht për nxënësit e sapoardhur dhe ata me çqetësime të sjelljes.

Përmbajtja shkencore e lëndës

Pyetja 13

Cilës klase (pjesë e ligjëratës) i përket fjala “*mallshëm*” në vargun: “*Kur bylbyli mallshëm kndon*”?

- A) Mbiemër
- B) Ndajfolje
- C) Parafjalë
- D) Pjesëz

Pyetja 14

Me çfarë është shprehur kundrinori i drejtë në fjalinë: “*Me sytë n’errësirë vetveten kërkon.*”?

- A) Emër me parafjalë në rasën dhanore
- B) Emër me parafjalë në rasën kallëzore
- C) Përemër i pacaktuar
- D) Përemër vetvetor

Pyetja 15

Cila është figura e sintaksës poetike që është përdorur në fjalinë: “*Ju ikët o bukuroshe dhe në vendin tuaj latë një lolo fytyrëngryset, gungaç dhe qorr me një sy*”?

- A) Asident
- B) Elipsë
- C) Enumeracion
- D) Inversion

Pyetja 16

Ç' lloj kallëzuesi është përdorur në fjalinë: “Ndërprerja e tij nuk qe e zakonshme.”?

- A) Kallëzues emëror
- B) Kallëzues i përbërë foljor
- C) Kallëzues i thjeshtë foljor
- D) Kallëzues me pjesë të pandryshueshme të ligjëratës

Pyetja 17

Cilit shkrimtar i përket ky përcaktim: “Është shembulli i krijuesit modern shqiptar, i cili e ngriti në kulm, madje në kult, krijimin poetik dhe poetin. Duke u mbështetur në trashëgiminë poetike të Naimit dhe të letërsisë moderne, ai krijoi poetikën origjinale, në të cilën ngrihet një univers emocionesh, idesh e idealesh, ku e vendos botën shqiptare”?

- A) Faik Konica
- B) Gjergj Fishta
- C) Lasgush Poradeci
- D) Migjeni

PS)C

Pyetja 18

Për të krijuar “Komedinë njerëzore”, Balzaku zbatoi parimin:

- A) e objektivizmit dhe impersonalizmit.
- B) e rimarrjes së temave, ideve dhe personazheve.
- C) e pasqyrimit simbolik të realitetit.
- D) e shpëtimit estetik të personazheve.

PS)B

Pyetja 19

Nëse një tekst argumentues mbyllet me një pyetje retorike, autori ka si qëllim:

- A) të përforcojë tezën.
- B) të përfshijë emocionalisht lexuesin.
- C) të përkufizojë problemin.
- D) të përmbledhë kuptimin e paragrafëve.

Pyetja 20

Kamy e realizon absurdin përmes një stili që karakterizohet nga:

- A) analiza e hollësishme psikologjike, e dhënë përmes rrëfimit të detajuar.
- B) rrëfimi simbolik, fragmentarizmi dhe përpunimi i lartë të shprehjes artistike.
- C) stili asnjanes dhe fjalitë e shkurtra që fshehin tensionin e brendshëm.
- D) rrëfimi me figuracion të pasur artistik.

Përmbajtja e programit orientues për orën e hapur mësimore

Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, përsa i përket mënyrës sesi ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve praktike etj. Përpos kësaj, që nxënësit të zotërojnë kompetencat, duhet të përvetësojnë konceptet dhe të zotërojnë shprehitë. Të dyja këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies gjatë orës mësimore, të cilat përmbushin rezultatet e të nxënësve dhe përshtaten me stilet e të nxënësve dhe nevojat e nxënësve.

Një mësimdhënie - nxënie e mirëmenëduar dhe e mirëplanifikuar, si dhe një mjedis të nxëni efektiv krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit, ashtu edhe atë të nxënësit. Kompetencat janë të ndërlidhura dhe zhvillohen në vazhdimësi nëpërmjet situatave të të nxënësve që kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve. Nxënësit janë aktivë kur përfshihen në veprimtari, eksplorime, ndërtime ose simulime të njohurive dhe të aftësive. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një mjedis dhe atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre.

Më poshtë janë paraqitur dy modele orësh mësimore për lëndën e lëndën e gjuhës shqipe në AMU dhe lëndën e letërsisë në *AML*, si dhe kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur.

Model ore mësimore për secilin nivel (AMU dhe AML)

Mësuesit janë të lirë të përzgjedhin vetë temën, klasën, metodat, teknikat, mjetet, veprimtaritë sipas stileve të të nxënit, instrumentet e vlerësimit etj., që do të përdorin gjatë zhvillimit të orës mësimore të hapur.

GJUHË SHQIPE, AMU

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Shiler “Vilhelm Tel” (ora e parë)			
Situata e të nxënit: Teatri			
Rezultatet e të nxënit			
Nxënësi: - tregon brendinë e tekstit duke u ndalur në pjesët kryesore të tij; - analizon personazhet e tekstit duke u ndalur te fjalët dhe veprimet e tyre; - identifikon mesazhin e tekstit.			
Burimet dhe mjetet mësimore: - Teksti shkollor - Youtube	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - Histori		
Metodologjia: bashkëbisedim, lexim me role, kllaster, diskutim, ditar dypjesësh etj.			
Organizimi i orës së mësimi:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve			
a) Bashkëbisedim			
Mësuesi			
<i>Drama dhe teatri</i>			
- A keni qenë ndonjëherë në teatër?			

- Ç' dramë ishte vënë në skenë?
- A ju ka pëlqyer? Çfarë ju ka bërë përshtypje më shumë?
- Po drama keni lexuar?
- Ju pëlqen më shumë të lexoni drama apo t'i shihni në teatër ose në televizion? Pse?

Shkrimtari

- A njihni ndonjë dramaturg?
- A keni dëgjuar për Shilerin? Po për dramat e tij?

Ndërtimi i njohurive të reja

a) Prezantimi i pjesës së re

Mësuesi përmbledh ose plotëson informacionin e nxënësve për autorin (shumë pak të dhëna për jetën dhe veprën e Shilerit) dhe për dramën “Vilhelm Tel”.

b) Leximi me role

Mësuesi ndan nxënësit sipas roleve. Pjesës tjetër që nuk do të lexojë, i kërkohet të japë gjykime në lidhje me interpretimin e shokëve të klasës. Lihen nxënësit për pak kohë që të familjarizohen me tekstin dhe më pas lexojnë me role pjesën.

c) Pyetje rreth të kuptuarit të tekstit

- Ku zhvillohen ngjarjet në këtë dramë?
- Çfarë kërkoi Gesleri nga Teli?
- Cili ishte shkaku?
- A iu bind menjëherë Teli Geslerit?
- Si reagues njerëzit e tjerë ndaj urdhrit të Geslerit?
- A u tërhoq Gesleri?
- Kush ishte Valteri?
- A u frikësua Valteri nga urdhri i Geslerit?

- A arriti ta qëllonte mollën Teli?

Çdo përgjigje e nxënësve shoqërohet me shembuj dhe detaje nga teksti.

d) Tregim i brendisë së tekstit

- Cilën pjesë mund ta konsiderojmë si pikë kulmore të këtij teksti?
- Kush mund ta thotë brendinë e tekstit duke u ndalur në pjesët kryesore?

1-2 nxënës tregojnë brendinë duke u ndalur në pjesët kryesore (hyrja, zhvillimi dhe pika kulmore). Mësuesi vlerëson nxënësit për tregimin e brendisë së tekstit.

e) Ilustrimet

Nxënësit diskutojnë rreth ilustrimeve në tekst:

Ilustrimet plotësojnë apo ilustrojnë brendinë e tekstit? Pse?

Mësuesi u kërkon nxënësve se çfarë do të shtonin ata më shumë në këto ilustrime.

f) Mesazhi i tekstit

Ditari dy pjesësh

Nxënësit punojnë në çift për formulimin e mesazhit të tekstit. Ata prezantojnë para të tjerëve mesazhin, duke argumentuar mendimin e tyre.

<i>Pyetja</i>	<i>Përgjigja</i>
Cili është mesazhi i këtij teksti?	<i>Shembull përgjigjeje:</i> Forca e njeriut qëndron jo te pozita shoqërore, por te karakteri dhe cilësitë shpirtërore të tij)

g) Analiza e personazheve

- Sa personazhe ka në këtë tekst? Cilët janë ata?
- Për cilin personazh doni të diskutojmë më parë? Pse?

Teli

- Ç' tipare ka Teli? (trim, i mençur, i dashur, i vendosur, kryengritës – fsheh edhe një shigjetë tjetër dhe nëse do t'i ndodhte diçka djalit, atëherë do të vriste Geslerin, fisnik etj.)
- A u përpoq Teli të bindte Geslerin? Ç' rrugë ndoqi? (i kujton që një prind nuk mund të qëllojë mbi kokën e të birit, duke menduar se do ta prekë në pikën e tij të dobët)
- Pse Teli vendosi ta qëllojë mollën mbi kokën e të birit? (deshi të provonte papërkulshmërinë e njerëzve të thjeshtë). Telit ia njihnin që të gjithë zotësinë si luftëtar. Ai nuk ishte frikacak sepse nuk iku dhe as iu përgjërua Geslerit. Teli, gjithashtu, nuk ishte mendjemadh dhe i pashpirt- duart që i dridhen, lutja që i bën Geslerit, sytë që i zgurdullon etj.
- Si e shfaq ai epërsinë e tij në raport me sundimtarin? (E qëllon mollën mbi kokën e të birit duke treguar kështu vlera fizike dhe shpirtërore)
- Çdo të kishit bërë në vend të Telit? Argumentoni zgjedhjen tuaj.

Gesleri

- Ç' tipare ka Gesleri?
- Ku duket mizoria e tij?
- Si e përfytyron Geslerin? Të bukur apo të shëmtuar?
- Gesleri ka vendosur që sa herë të përmendet emri i tij, njerëzit të varin kapelën e tyre mbi një hu. Si e gjykoni një veprim të tillë? Pse ju duket pa kuptim?
- Çfarë cilësish duhet të ketë që sundimtar që të meritojë nderimin dhe respektin e popullit të tij? Cili është mendimi juaj?

Valteri

- Si vizatohet Valteri? (trim, krenar, i pjekur për moshën e tij)
- Ku duken këto cilësi?

- Çfarë vlerësoni më shumë te ai?
- Ç'do të kishit bërë në vend të tij?

Shënim: Të gjitha cilësitë konkretizohen me detale nga teksti.

h) Diskutim

Mësuesi krijon mundësi që nxënësit të shohin një fragment në you tube nga drama “ Vilhelm Tel”.

www.bing.com/videos/search?q=vilhelm+tel+video&docid=607990326886085853&mid=893F42C9295891368C7D893F42C9295891368C7D&view=detail&FORM=VIRE


- Si i kishit imagjinuar personazhet e këtij teksti? Ku ndryshon Teli, Gesleri dhe Valteri i fragmentit që pamë, nga Teli, Gesleri dhe Valteri i imagjinatës suaj?

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

a) Kllaster i personazheve

Vizatoni kllasterin e tri personazheve të mësipërme

P.sh., Teli dhe Gesleri



b) Reflektim

- A ju pëlqeu ky tekst? Pse?
- Çfarë ju pëlqeu më shumë?
- Nëse do të shoqërohej me muzikë kjo pjesë, ç' lloj muzike do të ishte ajo? Pse?
- A do t'u pëlqente ta interpretonit me role?
- Çfarë mund të bëjë secili prej jush?

Vlerësimi i nxënësve

Niveli 2: Nxënësi u përgjigjet pyetjeve rreth brendisë së tekstit, analizon tiparet kryesore të personazheve.

Niveli 3: Nxënësi tregon brendinë e tekstit me fjalor të thjeshtë, analizon personazhet duke u ndalur kryesisht në fjalët e tyre dhe identifikon me ndihmën e mësuesit, mesazhin e tekstit.

Niveli 4: Nxënësi tregon me fjalor të pasur brendinë e tekstit duke u ndalur në pjesët kryesore të tij, analizon personazhet e tekstit duke u ndalur te fjalët dhe veprimet e tyre, si dhe identifikon mesazhin e tekstit.

Detyrë shtëpie

Mësuesi ndan nxënësit me grupe (regjisori, grupi që do të interpretojë rolet, grupi që do të merret me skenën, grupi që do të merret me kostumet, grupi që do të zgjedhë muzikën në sfond etj.) dhe kërkon nga nxënësit që javën e ardhshme ta vënë në skenë tekstin.

LETËRSI ME ZGJEDHJE, AML

Modeli i mëposhtëm është për dy orë të njëpasnjëshme në klasën e dymbëdhjetë (Letërsi me zgjedhje).

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi me zgjedhje	Shkalla: V	Klasa: XII
Temat mësimore: - Kënga legjendare e Gjergj Elez Alisë - Studim teksti “Gjergj Elez Alia”		Situatat e të nxënit: Virtytet e shqiptarit	
Rezultatet e të nxënit: Nxënësi: - analizon tekstin dhe personazhet e këngës; - gjykon veprimet e personazheve të këngës; - identifikon ngjashmëritë dhe dallimet mes kësaj kënge dhe krijimeve të tjera epike; - gjykon rreth vlerave letrare të këngëve të ciklit.		Fjalët kyç: <i>Kreshnik, dyluftim, bajloz, hiperbolë, triumf i së drejtës, triumf i jetës mbi vdekjen.</i>	
Burimet: - <i>Libra, artikuj enciklopedie, shkrime të tjera për folklorin;</i> - <i>Teksti i nxënësit</i>		Lidhja me fushat e tjera: - Gjuha shqipe - Historia - Qytetaria	
Organizimi i orës së mësimi: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve 📁 Bashkëbisedim Kënga e Gjergj Elez Alisë është shumë e njohur për nxënësit, ndaj procesi mësimor mund të fillojë duke aktivizuar njohuritë e mëparshme të nxënësve në formën e një bashkëbisedimi. - Kush ishte Gjergj Elez Alia?			

- Pse kjo këngë është pjesë e Ciklit të Kreshnikëve? Çfarë ka të përbashkët kjo këngë me këngët e tjera të Ciklit të Kreshnikëve?
- Çfarë tematike trajton kjo këngë?
- Etj.

Ndërtimi i njohurive të reja

Gjatë kësaj pjese të orës së mësimi, nxënësit, pasi të kenë lexuar fragmentin e këngës, do të flasin rreth fabulës së saj (subjektit të këngës).

Kuptojmë tekstin

Për të kuptuar më mirë përmbajtjen e këngës ndajeni atë në pjesë. Pjesa e parë ndahet në katër grupe vargjesh.

Vendosni nga një titull për secilën pjesë. Tregoni shkurtimisht se çfarë rrëfëhet në secilën pjesë.

- Pjesa I – (vargu 1 – 12) - Parashtrimi dhe hyrja e këngës na njeh me personazhet dhe gjendjen e tyre.
- Pjesa II – (vargu 13 – 25) - Lajmi për ardhjen e bajlozit të zi.
- Pjesa III – (vargu 26 – 83) - Dialogu motër – vëlla.
- Pjesa IV – (vargu 84 – 121) - Përballja me nallban probatinin dhe nallban jaranin.

Gjergj Elez Alia ka nëntë vjet që lëngon në shtrat me nëntë plagë në trup. Ku i ka marrë ai këto plagë?

Edhe pse nuk thuhet në këngë, nënkuptohet që këto plagë janë marrë në beteja dhe luftëra të ndryshme. Këtë e kuptojmë përmes epitetit *trim mbi trima* që përdoret që në fillim, që le të kuptohet se bëhet fjalë për një trim luftëtar.

Ç' tregon kjo për figurën e kreshnikut?

Kjo e lartëson figurën e luftëtarit dhe e bën atë të ngjashme me një kreshnik, figurë madhështore dhe heroike.

Cila është domethënia e përdorimit të numrit 9?

Përdorimi i numrit 9 është një element simbolik i traditës popullore dhe epikës heroike, por njëkohësisht merr vlerën e një hiperbolizimi, për të lartësuar figurën heroike të Gjergjit.

Si është dhënë në këtë këngë lidhja motër – vëlla?

Përmes dialogut motër-vëlla, në pjesën e parë të këngës, vihet re lidhja e ngushtë dhe tepër e fortë mes vëllait dhe motrës. Në të shihen tipare të familjes tradicionale shqiptare, ku roli i vëllait është ai i mashkullit të parë të shtëpisë, pas vdekjes së prindërve, i cili duhet të kujdeset për motrën e tij. Motra që zëvendëson nënën, përfaqëson figurën femërore në këtë familje. Ajo duhet të kujdeset për shtëpinë dhe vëllanë. Kjo lidhje e ngushtë, shprehet edhe në vargjet anaforikë:

A thue s'pate me ngranë e me pi?

A t'la keq ty vllau për veshë e mbathë?

A mos t'u randue ndojherë me fjalë?

Përmes këtyre vargjeve shprehet koncepti i rolit të vëllait dhe detyrimeve të tij ndaj motrës.

Lexoni vargjet e mëposhtme:

“Ç’je kan thue, bre burrë, goja t’u thaftë!

Jam kanë nisë tu dera e probatinit,

qe nandë vjet qi gjogu ksajt s’ka ra,

m’fal se ndeshkjam derën e magjupit!

Se kta syj nji herë unë ua kam falë

tats’ e nans’qi kalben për nan dhe,

Gjergjit tem qi kalbet varrsh’ mbi dhe!”

Kujt ia drejton këto fjalë motra e Gjergjit?

Cila është domethënia e këtyre fjalëve?

Çfarë cilësish të motrës dalin përmes tyre?

Pse ajo nuk jepet me një emër të përveçëm?

Në këto vargje jepet portreti moral dhe ngrihet në kult ideali femëror i shqiptares, e cila nuk mund t'i jepet kujt do, madje as nuk përulet para provokimeve të tilla të ulëta. Ajo i është përkushtuar familjes dhe vëllait të saj. Ky përkushtim e lartëson atë si një figurë femërore përfaqësuese të idealit femëror të shqiptarit. Kjo shprehet edhe me faktin që nuk përmendet me emër, një tregues i përgjithësimit popullor të figurës së saj.

Cilat virtyte të Gjergj Elez Alisë pëlqeni? (kllaster)

Nxënësit punojnë në grupe dhe i shprehin përgjigjet e tyre në formën e një kllasteri.

Punë e pavarur: Ditari trepjesësh

Gjatë orës së dytë të mësimit do të punohet studim teksti “Kënga e Gjergj Elez Alisë”. Kjo pjesë punohet në formën e një komenti dhe mund të përdoret teknika *Ditari trepjesësh*.

Kjo teknikë është e bazuar në ditarin dypjesësh, por i vetmi dallim tek ditari trepjesësh kemi plotësimin e shtyllës së tretë të ditarit.

Tek ditari trepjesësh kemi shtyllën e parë, shtyllën e mesme, (të dytë) dhe shtyllën e tretë në të cilën bëhet arsyetimi i mendimit, përgjigjes, bëhet prova e detyrës, bëhet vizatimi, skema etj.

Analizojmë tekstin

Analizoni figurën e Bajlozit.

- Si është përshkruar ai?
- Çfarë roli luan epiteti “i zi”?
- Po lidhja me detin, çfarë ndikimi ka në këtë këngë? Pse ai vjen nga deti??

- Në ç' raport qëndron ai me Gjergjin?

Veprimi është karakteristika kryesore e këngëve epike. Dyluftimi në këtë këngë përbën edhe pikën kulmore të saj.

- Si është dhënë nga rapsodi dyluftimi mes këtyre dy luftëtarëve?
- Pse ata ndeshen fillimisht me fjalë?
- Po ironia çfarë vlere ka në këtë betejë?
- Ku qëndron ngjashmëria mes dyluftimit të Akilit dhe Hektorit dhe dyluftimit të Gjergjit dhe Bajlozit?
- A gjeni ngjashmëri të tjera të kësaj kënge me “Iliadën” ose “Odisenë”?

Hiperbola është figurë qendrore e këngëve epike. Rapsodi e përdor këtë figurë për të përforcuar edhe më tepër përshtypjen, për të vënë në dukje më mirë figurën.

Gjeni disa nga hiperbolat e përdorura në këtë këngë.

Ç' përshtypje artistike krijojnë ato?

Shpjegoni përdorimin e figurës së hiperbolën në dyluftimin me armë të Gjergji dhe Bajlozit.

Te vargu “A dalë zani e paska marrun dhenë”, kemi përdorimin e foljes në mënyrën habitore. Me këtë, rapsodi duket sikur do të na flasë për një mrekulli.

Nënvizoni në pjesën e dytë të këngës foljet e përdorura në mënyrën habitore.

Çfarë funksioni kryejnë ato?

Fundi i këngës “Gjergj Elez Alia” (Rrjeti i diskutimit)

Po -	A e konsideroni tragjik fundin e kësaj kënge?	Jo
------	---	----

A mbani mend raste të tjera, kur krijimet folklorike kanë një fund të tillë?

Si quhet kjo dukuri?

Çfarë tregon kjo për popullin tonë?

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Reflektim: Shkrim i lirë

Në poemën “Lahuta e Malcisë” të Gjergj Fishtës, kënga e Tringës mbështetet në modelin e këngës së Gjergj Elez Alisë.

Gjeni të përbashkëtat dhe të veçantat:

- në subjekt;
- në lidhjen vëlla-motër;
- në mesazh.

Cilat janë motivet që e shtyjnë Tringën të qëndrojë deri në fund?

A janë të ngjashme me motivet që e shtyjnë Gjergj Elez Alinë?


Vlerësimi: Mësuesi mban shënime në evidencë për disa nxënës që demonstrojnë njohuri rreth këngës së Gjergj Elez Alisë, aftësi për të kuptuar, për të interpretuar dhe për të vlerësuar tekstin e kësaj kënge, si dhe për të analizuar personazhet e tekstit. Vlerësimi i nxënësve bëhet duke u bazuar në rezultatet e të nxënësve.

Niveli 2:

- identifikon tiparet e personazheve të këngës;
- dallon veprimet e personazheve të këngës;
- identifikon disa ngjashmëri dhe dallime mes kësaj kënge dhe krijimeve të tjera folklorike.

Niveli 3:

- analizon mirë tekstin dhe personazhet e këngës;
- interpreton veprimet e personazheve kryesore të këngës;
- dallon disa ngjashmëri dhe dallime mes kësaj kënge dhe krijimeve të tjera epike;

- 
- identifikon vlerat letrare të këngëve të ciklit.

Niveli 4:

- analizon në mënyrë të plotë tekstin dhe personazhet e këngës;
- gjykon veprimet e personazheve të këngës;
- identifikon ngjashmëritë dhe dallimet mes kësaj kënge dhe krijimeve të tjera epike;
- gjykon rreth vlerave letrare të këngëve të ciklit.

Kriteret e vlerësimit të orës mësimore

Kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur:

- mbështesin mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit për të planifikuar dhe për të organizuar një orë mësimore sa më cilësore dhe efektive për arritjet e nxënësit;
- i shërbejnë drejtuesit dhe anëtarëve të rrjetit profesional, drejtuesit të shkollës, si dhe pjesëmarrësve të tjerë gjatë zhvillimit të orës mësimore të hapur për të gjykuar dhe vlerësuar cilësinë dhe efektivitetin e kësaj ore mësimore;

Zhvillimi i orës së hapur mësimore, diskutimet, komentet, vlerësimet, sugjerimet e kolegëve u krijojnë mundësi të gjithë mësuesve të shkëmbejnë përvoja pozitive dhe të identifikojnë anë të pozitive të një ore mësimore cilësore, për t'i bërë pjesë të punës së tyre të përditshme.

Kriteret për vlerësimin e orës mësimore të hapur

Kriteret për vlerësimin e orës së hapur mësimore				
Gjithsej 70 pikë				
Përshkruesit	Niveli 1 - Dobët	Niveli 2 - Mjaftueshëm	Niveli 3 - Mirë	Niveli 4 - Shumë mirë
Planifikimi i orës së hapur mësimore (10 pikë)				
Mësuesi ka planifikuar të gjithë komponentët e orës së mësimit në mënyrë koherente dhe në përmbushje të rezultateve të të nxënësit.	0 – 1 pikë	2 – 3 pikë	4 pikë	5 pikë
	Mësuesi ka planifikuar orën mësimore pa pasur një koherencë të komponentëve. Rezultatet e të nxënësit (RN) nuk bazohen në programin lëndor dhe mësuesi nuk ka planifikuar situatë të nxëni. Metodologjia është tradicionale dhe për më tepër nuk lidhet me stilet e të nxënësit.	Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënësit sipas programit lëndor. Gjithashtu mësuesi ka planifikuar situatë të nxëni, e cila nuk ndikon shumë në përmbushjen e rezultateve të të nxënësit (RN) ose nuk ka planifikuar situatë të nxëni. Organizimi i	Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënësit sipas programit lëndor. Gjithashtu mësuesi ka planifikuar situatë të nxëni, si dhe ka planifikuar organizimin e nxënësve. Metodat dhe teknikat mësimore janë në koherencë me RN-të, por nuk përputhen me situatën e të nxënësit	Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënësit sipas programit lëndor. Gjithashtu mësuesi ka planifikuar situatë të nxëni, të cilën e ka përdorur si pjesë e metodologjisë së mësimdhënies, ka planifikuar organizimin e nxënësve dhe metodologjinë në koherencë me RN-të dhe me stilet e të

	<i>Pyetjet që u drejtohen nxënësve nuk janë sipas niveleve.</i>	<i>nxënësve në klasë është tradicional dhe nuk është i lidhur me stilet e të nxënësve. Pyetjet në përgjithësi janë sipas niveleve.</i>	<i>dhe me stilet e të nxënësve. Mësuesi ka planifikuar pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.</i>	<i>nxënësve, si dhe ka planifikuar pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.</i>
Mësuesi ka planifikuar për temën mësimore qasje të reja inovative që lidhen me demonstrimin e kompetencave të të nxënësve gjatë gjithë jetës, krahas kompetencave lëndore.	0 – 1 pikë <i>Mësuesi ka një planifikim ditor rutinë, pa u kujdesur për qasje të reja inovative dhe pa përfshirë edhe zhvillimin e kompetencave kyç të të nxënësve gjatë gjithë jetës.</i>	2 – 3 pikë <i>Mësuesi në planifikimin e tij ka qasje më së shumti tradicionale. Metodat e planifikuara fokusohen më së shumti te konceptet lëndore, duke lënë mënjanë kompetencat kyç të të nxënësve gjatë gjithë jetës.</i>	4 pikë <i>Mësuesi në planifikimin e tij ka qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin e TIK-ut dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Nga ana tjetër metodat e planifikuara përqendrohen më së shumti te konceptet lëndore, duke lënë mënjanë kompetencat kyç të të nxënësve gjatë gjithë jetës.</i>	5 pikë <i>Mësuesi në planifikimin e tij kujdeset që të planifikojë qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin TIK-ut dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Gjithashtu ai kujdeset që nëpërmjet metodave të planifikuara të përfshijë edhe rezultate të kompetencave kyç të të nxënësve gjatë gjithë jetës.</i>
Mjedisi i të nxënësve (14 pikë)				
Mësuesi ka krijuar një klimë pozitive, ku nxënësve trajtohen në mënyrë të barabartë, shprehin lirshëm mendimet e tyre, respektojnë	0 – 1 pikë <i>Mësuesi krijon një mjedis jo miqësor në klasë, ku jo të gjithë nxënësve kanë mundësi për t'u shprehur lirshëm. Gjatë orës së mësimi vetëm disa nxënës</i>	2 – 3 pikë <i>Mësuesi krijon një mjedis tradicional në klasë, ku nxënësve nuk kanë shumë komunikim me njëri-tjetrin. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxënësve,</i>	4 - 5 pikë <i>Mësuesi kujdeset që nxënësve të respektojnë njëri-tjetrin dhe të jenë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxënësve, por jo të gjithë</i>	6 - 7 pikë <i>Mësuesi promovon suksesin e çdo nxënësve duke krijuar një klimë pozitive dhe mjedis miqësor, ku të gjithë respektojnë njëri-tjetrin dhe janë tolerantë duke pranuar mendimin</i>

njëri -tjetrin dhe pranojnë mendimin ndryshe.	<i>ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i>	<i>por jo të gjithë ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i>	<i>ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i>	<i>ndryshe. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxëni për të gjithë duke nxitur besimin dhe vlerësimin për veten.</i>
Mësuesi angazhon dhe përfshin të gjithë nxënësit duke i nxitur dhe motivuar të ndërmarrin iniciativa, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.	<i>0 – 1 pikë</i> <i>Mësuesi organizon orën e mësimit në mënyrë tradicionale, ku pak nxënës përfshihen. Vetëm disa nxënës nxiten të marrin pjesë në mësime, të tjerët nuk nxiten me detyra motivuese. Mësuesi nuk u kushton vëmendje të gjithëve lidhur me pyetjet që ata i drejtojnë gjatë orës së mësimit.</i>	<i>2 – 3 pikë</i> <i>Mësuesi organizon orën e mësimit në mënyrë tradicionale, ku jo gjithë nxënësit përfshihen dhe angazhohen. Vetëm disa nxënës nxiten të marrin pjesë në mësime dhe të ndërmarrin iniciativa. Ai u kushton vëmendje, por nuk u jep mundësi të gjithëve të marrin një përgjigje.</i>	<i>4 - 5 pikë</i> <i>Mësuesi organizon orën e mësimit duke u kujdesur që të gjithë nxënësit të përfshihen dhe angazhohen, por nuk i nxit ata me detyra motivuese duke i lënë disi pasiv.. Ai i kushton vëmendje kur ata shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje, por nuk u jep mundësi të gjithëve të marrin një përgjigje.</i>	<i>6 - 7 pikë</i> <i>Mësuesi organizon orën e mësimit duke u kujdesur që të gjithë nxënësit të përfshihen dhe angazhohen me detyra motivuese, si dhe i nxit ata të ndërmarrin iniciativa. Ai u kushton vëmendje, kur ata shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.</i>
Metodat mësimore (21 pikë)				
Mësuesi organizon nxënësit në varësi të metodave që do të përdorë dhe stileve të të nxënit.	<i>0 – 1 pikë</i> <i>Mësuesi nuk organizon nxënësit në varësi të metodës së përzgjedhur dhe demonstroi që nuk i njeht stilet e të nxënit. Ora e mësimit është rutinë dhe kryesisht tradicionale.</i>	<i>2 – 3 pikë</i> <i>Mësuesi demonstroi që i njeht stilet e të nxënit të nxënësve të tij, por ora e mësimit është tradicionale pa u kujdesur që nxënësit të përmirësojnë arritjet e tyre bazuar në stilin e tyre të të nxënit.</i>	<i>4 - 5 pikë</i> <i>Mësuesi demonstroi që i njeht stilet e të nxënit të nxënësve të tij, por metodat e teknikave që përdor në orën e mësimit nuk përfshijnë të gjitha stilet e të nxënit duke krijuar kushte që jo të gjithë nxënësit të përmirësojnë arritjet e tyre.</i>	<i>6 - 7 pikë</i> <i>Mësuesi demonstroi që i njeht shumë mirë stilet e të nxënit të nxënësve të tij dhe përdor metoda e teknika që i lidh më së miri me stilet e të nxënit duke u dhënë mundësi nxënësve të përmirësojnë arritjet e tyre.</i>

	0 – 1 pikë	2 – 3 pikë	4 - 5 pikë	6 - 7 pikë
Mësuesi përdor metoda që nxisin mendimin kritik, krijues, që nxisin diskutimin (apo debatin).	<i>Mësuesi demonstroi që nuk ka njohuri në përdorimin e metodave të ndryshme gjatë orës së mësimit duke u përqendruar më shumti vetëm tek ato tradicionale. Gjatë zhvillimit të orës mësimore, mësuesi përqendrohet më shumti te të mësuarit mekanik e riprodhues dhe nuk nxiten shprehitë e të menduarit në mënyrë kritike.</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri të kufizuara për përdorimin e metodave të ndryshme gjatë orës së mësimit duke u përqendruar më shumti vetëm tek ato tradicionale. Gjatë zhvillimit të orës mësimore, vetëm disa nxënësve u jep mundësi të diskutojnë apo të demonstrojnë shprehitë e mendimit kritik.</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri për disa metoda të mësimdhënies. Gjatë zhvillimit të orës mësimore, mësuesi përdor ndonjë metodë apo teknikë që nxit mendimin kritik dhe krijues te nxënësit, por vetëm disa nxënësve u jep mundësi të diskutojnë gjatë orës së mësimit.</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri shumë të mira për shumëllojshmërinë e metodave të mësimdhënies. Gjatë zhvillimit të orës mësimore, mësuesi përdor metoda dhe teknika që nxisin mendimin kritik dhe krijues te nxënësit, që nxisin diskutimin (apo debatin) dhe u jep mundësi të gjithë nxënësve të përfshihen gjatë orës së mësimit.</i>
Mësuesi drejton pyetje të niveleve dhe të llojeve të ndryshme dhe nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit.	<i>Mësuesi demonstroi që nuk ka njohuri për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve dhe të niveleve të ndryshme Gjithashtu pyetjet i drejton vetëm mësuesi dhe nuk nxit nxënësit të bëjnë pyetje.</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri të kufizuara për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve të ndryshme dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit, por nuk u jep mundësi nxënësve të përgjigjen vetë.</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai përdor lloje të kufizuara pyetjesh dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu mësuesi nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit, por nuk u jep mundësi nxënësve të përgjigjen vetë.</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri shumë të mira për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai i përdor këto gjatë gjithë orës mësimore dhe gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit dhe pyetje njëri – tjetrit.</i>

Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve (17 pikë)				
Mësuesi vlerëson për të identifikuar nevojat për përmirësim të nxënësit dhe lehtëson procesin e nxënies së tij.	0 – 1 pikë <i>Mësuesi e përdor vlerësimin e nxënësit për të matur vetëm arritjet e tij në orën e mësimit.</i>	2 – 3 pikë <i>Mësuesi demonstroi se e përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit. Mësuesi përdor vlerësimin e nxënësit për të matur vetëm arritjet e nxënësit në orën e mësimit.</i>	4 - 5 pikë <i>Mësuesi demonstroi se e përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit Ai e përdor vlerësimin e nxënësit për të matur vetëm arritjet e nxënësit në orën e mësimit duke identifikuar nevojat për përmirësim të tij.</i>	6 - 7 pikë <i>Mësuesi demonstroi se e përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit Ai përdor vlerësimin për identifikuar pikat e forta të tij, si dhe nevojat për përmirësim të nxënësit duke e mbështetur dhe lehtësuar në procesin e nxënies së nxënësit.</i>
Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit sipas niveleve të arritjes.	0 – 1 pikë <i>Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi, por nuk përdor nivelet e arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore.</i>	2 – 3 pikë <i>Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi bazuar në nivelet e arritjes dhe në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore.</i>	4 pikë <i>Mësuesi demonstroi se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme vlerësimi bazuar në nivelet e arritjes dhe në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore.</i>	5 pikë <i>Mësuesi demonstroi se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit, sipas niveleve të arritjes dhe rezultateve të të nxënësit të orës mësimore.</i>
Mësuesi angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënësit dhe nevojave të nxënësve.	0 – 1 pikë <i>Mësuesi jep detyra për të gjithë nxënësit njësoj, pa marrë parasysh stilet e të nxënësit apo</i>	2 – 3 pikë <i>Mësuesi demonstroi se njeh nevojat e nxënësve, por angazhon vetëm disa nxënës me detyra të diferencuara.</i>	4 pikë <i>Mësuesi demonstroi se njeh nevojat e nxënësve dhe angazhon nxënësit me detyra të diferencuara,</i>	5 pikë <i>Mësuesi demonstroi se njeh nevojat e nxënësve dhe angazhon nxënësit me detyra të diferencuara, sipas stileve të të</i>

	<i>nevojat e nxënësve.</i>		<i>duke u bazuar në nevojat e tyre.</i>	<i>nxënit dhe nevojave të tyre.</i>
Përdorimi i mjeteve didaktike dhe digjitale (8 pikë)				
Mësuesi përdor mjetet mësimore didaktike për temën mësimore.	0 – 1 pikë <i>Mësuesi nuk përdor mjete mësimore didaktike për arritjen e rezultateve të nxënit të temës mësimore.</i>	2 pikë <i>Mësuesi përdor vetë mjetet mësimore didaktike, të cilat janë të kufizuara për zhvillimin e plotë të rezultateve të nxënit të temës mësimore.</i>	3 pikë <i>Mësuesi përdor vetë mjetet mësimore didaktike të përshtatshme në përmbyshje të rezultateve të nxënit të temës mësimore, por nuk angazhon shumë nxënësit në përdorimin e tyre.</i>	4 pikë <i>Mësuesi ka krijuar mjete mësimore didaktike dhe i përdor ato në përmbyshje të rezultateve të nxënit të temës mësimore duke vënë edhe nxënësit në përdorim të tyre në mënyrë që të nxisë të nxënësit të mësuarin praktik dhe krijues.</i>
Mësuesi përdor mjete digjitale për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve.	0 – 1 pikë <i>Mësuesi nuk përdor mjete digjitale në përmbyshje të rezultateve të nxënit të temës mësimore,</i>	2 pikë <i>Mësuesi përdor me ndihmën e tjerëve mjete digjitale, por përmbyshja nuk lidhet shumë me rezultatet e nxënit të temës mësimore.</i>	3 pikë <i>Mësuesi përdor vetë mjete digjitale në përmbyshje të rezultateve të nxënit të temës mësimore, por nxënësit nuk angazhohen në përdorimin e TIK-ut.</i>	4 pikë <i>Mësuesi përdor mjete digjitale dhe angazhon nxënësit në kryerjen e veprimtarive që kërkojnë përdorimin e TIK-ut, në përmbyshje të rezultateve të nxënit të temës mësimore dhe për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve.</i>

Përmbajtja e programit orientues për projektin kurrikular


Projekti është një strategji e të nxënësve me në qendër nxënësin, përmes të cilit nxënësit, si anëtarë të një grupi, hulumtojnë mbi një çështje të caktuar ose zgjidhin një problem që lidhet me klasën, shkollën ose komunitetin e tyre. Projekti nxit ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave kyçe dhe lëndore.

Ndryshe nga orët mësimore standarde në klasë, projektet kurrikulare janë më gjithëpërfshirëse, duke i lejuar nxënësit të bëjnë kërkime, të mendojnë në mënyrë kritike dhe të angazhohen në veprimtari praktike në të cilat eksplorojnë dhe zbatojnë në mënyrë krijuese njohuritë e tyre, si dhe zgjidhin probleme.

Projektet kurrikulare kërkojnë që nxënësit të marrin pjesë në mënyrë aktive në procesin mësimor. Ata bëhen nxënës aktivë që marrin pronësinë e arsimimit të tyre, kryejnë kërkime, analizojnë të dhënat dhe zbatojnë njohuritë e tyre në situata të botës reale. Nxënësit mund të shohin rëndësinë dhe praktikitetin e asaj që po mësojnë ndërsa trajtojnë problemet nga jeta praktike, eksplorojnë tema me interes personal ose adresojnë çështje të komunitetit.

Projektet kurrikulare përfshijnë integrimin e njohurive dhe aftësive nga fusha të shumta lëndore, duke i lejuar nxënësit të krijojnë lidhje dhe të shohin ndërlidhjen e disiplinave të ndryshme. Në projekte, nxënësit punojnë në ekipe, duke ndarë idetë, perspektivat dhe ekspertizën. Ata angazhohen në aftësi të menduarit të nivelit më të lartë, të tilla si zbatimi i njohurive, sintetizimi i informacionit dhe marrja e vendimeve. Kjo promovon zhvillimin kognitiv dhe përgatit nxënësit për sfida përtej klasës.

- *Projekti kurrikular nuk duhet të përmbajë njohuri të reja.*
- *Projekti kurrikular shtrihet përgjatë gjithë vitit shkollor, pra në të tri periudhat.*
- *Mësuesi që kur planifikon projektin duhet të ketë në vëmendje vlerësimin e tij. Vlerësimi nuk është diçka që ndodh vetëm në fund të projektit, mësuesi vlerëson nxënësit dhe përgjatë zhvillimit të tij.*
- *Planifikimi dhe zbatimi në mënyrë efektive i një projekti kërkon që mësuesi të përcaktojë qartë detyrën mësimore në detaje për çdo grup dhe nxënës (është mjaft e rëndësishme që secili nxënës të jetë i përfshirë dhe i angazhuar me detyra të përcaktuara); të paraqesë rezultatet e të nxënësve që do të arrihen nëpërmjet projektit; të paraqesë hollësisht çdo fazë të realizimit të projektit; të qartësojë nxënësit për arritjen përfundimtare të projektit; të*



qartësojë nxënësit për kriteret e vlerësimit të projektit; të vëzhgojë dhe të japë gjykimin e tij në mënyrë të vazhdueshme për ecurinë e zbatimit të projektit.

- *Për procesin e kualifikimit mësuesi organizon prezantimin e produkteve të nxënësve gjatë zhvillimit të projektit kurrikular.*

Fazat kryesore që ndiqen për realizimin e projektit kurrikular janë:

- Përcaktohet çështja ose problemi për të cilin do të hulumtohet, në mënyrë që të jetë i menaxhueshëm në kohë.
- Përcaktohen detyrat që duhet të realizohen për të grumbulluar të dhënat e nevojshme nga puna e secilit nxënës.
- Grumbullohet materiali dhe/ose mjetet e nevojshme.
- Përpunohen dhe analizohen të dhënat e grumbulluara.
- Nxirren përfundime dhe përgjithësime nga të dhënat e grumbulluara dhe përgatitet produkti përfundimtar.
- Prezantohen gjetjet dhe përfundimet e projektit ose prezantohet produkti i krijuar.

Modele të projekteve kurrikulare për nxënësit në AMU dhe AML

Model i një projekti kurrikular për nxënësit në AMU

Tema e projektit: Krijimi i një reviste për nxënësit e shkollës

Kohëzgjatja: 8 orë mësimore (të shpërndara përgjatë të tria periudhave)

Klasa: IX

Rezultatet e të nxënësit:

Nxënësi:

- hulumton në burime të besueshme për të gjetur informacion në lidhje me projektin;
- shkruan tekste të ndryshme si: reportazhi, intervista, artikulli etj.;
- punon në grup për të krijuar një produkt final të strukturuar dhe tërheqës;
- përzgjedh ilustrimet ose fotografitë e duhura për të plotësuar ose për të ilustruar përmbajtjen e teksteve të shkruara.
- korrigjon tekstet e shkruara për gabimet drejtshkrimore dhe për anën përmbajtësore.

Konceptet kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit:

- Reportazh, intervistë, artikull informues etj.
- Organizimi dhe struktura e një reviste: Përmbajtja, ballina, ndarjet tematike.
- Përgatitja e materialeve përmbajtësore dhe pamore.

Ndarja në grupe:

Nxënësit ndahen në grupe pune dhe secili grup merr përsipër një pjesë të revistës si p.sh: grupi i artikujve, grupi i intervistave, grupi i reportazhit, grupi i përmbajtjes vizuale (fotografi, ilustrime) dhe grupi i redaktimit.

Burimet kryesore të informacionit:


- Intervista dhe anketa me bashkëmoshatarët për temat më interesante për ta.
- Hulumtime në revista për të rinjtë dhe materiale të tjera si referencë për strukturën dhe tematikën e revistës.
- Biblioteka shkollore dhe interneti për hulumtim të thelluar mbi tema specifike të përzgjedhura nga nxënësit.

Temat e orëve të planifikuara të projektit:

1. Prezantimi i temës së projektit dhe zgjedhja e tematikave që nxënësit do të mbulojnë në revistë (*sport, kulturë, teknologji, shëndetësi etj.*).
2. Krijimi i grupeve të punës dhe ndarja e roleve: redaktorët, gazetarët, dizajnerët dhe përgjegjësit për intervistat.
3. Mbledhja e informacionit dhe realizimit e intervistave: Nxënësit mësojnë dhe praktikojnë si të kryejnë intervista dhe të mbledhin informacion të rëndësishëm për temat e tyre.
4. Hulumtimi dhe shkrimi i artikujve, reportazheve dhe tregimeve: Ky grup shkruan artikuj informues dhe të strukturuar bazuar në temat e përzgjedhura.
5. Fotografimi dhe ilustrimi: Ky grup mbledh fotografi dhe krijon ilustrime që përputhen me temat e revistës.
6. Redaktimi dhe rregullimi i përmbajtjes: Grupi i redaktorëve rishikon dhe bën përmirësimet e nevojshme për çdo artikull.
7. Dizajnimi i faqesjes: Grupi për pjesën vizuale dhe redaktorët punojnë së bashku për të krijuar faqesjen e revistës në një format tërheqës.
8. Prezantimi i produktit final përpara klasës: Çdo grup prezanton pjesën e vet dhe reflekton mbi punën e realizuar.

Veprimtaritë kryesore sipas temave:

- Realizimi i intervistave: Nxënësit përzgjedhin bashkëmoshatarë ose mësues për të kryer intervista rreth temave që interesojnë të rinjtë.
- Shkrimi i artikujve dhe i reportazheve: Çdo nxënës shkruan një artikull të shkurtër ose reportazh të bazuar në hulumtimet dhe interesat e nxënësve të shkollës.
- Krijimi i faqesjes vizuale të revistës: Nxënësit vendosin fotot, titujt dhe ngjyrat që e bëjnë revistën të duket sa më tërheqëse dhe interesante.

- 
- Redaktimi i përmbajtjes dhe shkrimi i ballinës: Grupi i redaktorëve sigurohet që përmbajtja të jetë e saktë, e rrjedhshme dhe pa gabime.

Përshkrimi i produktit të projektit:

Produkti final do të jetë një revistë shkollore e printuar ose digjitale me përmbajtje tërheqëse për nxënësit, e strukturuar në rubrika dhe e përgatitur nga vetë nxënësit. Revista mund të shpërndahet në shkollë ose të postohet online për lexim.

Vlerësimi i nxënësve::

- *Vlerësimi i përmbajtjes, strukturës dhe gjuhës së teksteve:* Cilësia e artikujve, intervistave dhe materialeve të tjera të krijuara nga nxënësit.
- *Angazhimi dhe bashkëpunimi në grup:* Përfshirja e secilit anëtar në grup dhe bashkëpunimi për të arritur produktin final.

Model i një projekti kurrikular për nxënësit në AML

Tema e projektit: Migjeni në skenë: dramatizimi i novelave

Kohëzgjatja: 6 orë mësimore (të shpërndara përgjatë të tria periudhave)

Klasa: XII

Rezultatet e të nxënësit:

Nxënësi:

- demonstroi të kuptuarit dhe analizon novelat e Migjenit;
- shkruan tekste dramatike me didaskali, monologë dhe dialogë duke u bazuar në novelat e Migjenit;
- interpreton gjatë vënies në skenë të dramatizimeve të novelave të Migjenit;
- punon në grup për realizimin e projektit.

Konceptet kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit:

- Dramatizimi i një teksti letrar dhe vënia në skenë.
- Analiza e subjektit dhe zhvillimi i personazheve.
- Konteksti historik dhe kulturor në krijimtarinë e Migjenit.

Bashkëpunëtorët:

Një aktor mund të angazhohet për asistencë teknike dhe mbështetje për realizimin e shfaqjes.

Prindër që mund të angazhohen në dekorin e skenës.

Burimet kryesore të informacionit:

- “Novelat e qytetit të veriut” Migjeni
- Artikuj dhe studime mbi kontekstin historik dhe letërsinë shqiptare të shekullit XX.
- Informacione për dramaturgjinë dhe teknikat e shfaqjes teatrale.

Temat e orëve të planifikuara të projektit:

- Prezantimi i temës së projektit: Diskutim mbi rëndësinë e Migjenit dhe veprat e tij.
- Leximi dhe analiza e novelave.
- Krijimi i skenarëve: Nxënësit punojnë në grupe për të shkruar skenarë të bazuar në novelat e zgjedhura.
- Përgatitja për vënien në skenë: Praktikimi për aktrimin.
- Përgatitja e shfaqjes: Organizimi i skenografisë dhe veshjeve, si dhe provat për shfaqjen.
- Shfaqja përfundimtare: Realizimi i shfaqjes për klasën, prindërit dhe/ose komunitetin.
- Reflektimi mbi procesin: Nxënësit diskutojnë për përvojën e tyre gjatë projektit dhe ndjesitë rreth shfaqjes.

Veprimtaritë kryesore sipas temave:

Leximi dhe analiza

- *Nxënësit lexojnë dhe analizojnë novelat e Migjenit.*

Krijimi i skenarëve

- *Nxënësit shkruajnë skenarë për dramatizimin e një novele të zgjedhur nga ata.*
- *Nxënësit punojnë mbi dialogët dhe ndarjen e skenave.*
- *Nxënësit krijojnë skicën e shfaqjes dhe organizojnë kronologjinë.*

Aktorët dhe interpretimi

- *Nxënësit studiojnë personazhet e zgjedhura dhe punojnë për interpretimin e tyre.*
- *Nxënësit organizojnë prova të përbashkëta për t'u përgatitur për shfaqjen përfundimtare.*
- *Nxënësit ofrojnë feedback dhe ndihmën e nevojshme për grupet e tjera.*

Skenografia, veshjet dhe shfaqja

- *Nxënësit krijojnë skenografinë e nevojshme për shfaqjen.*
- *Nxënësit kontribuojnë në krijimin e veshjeve të personazheve.*
- *Nxënësit përcaktojnë vendin e shfaqjes dhe kujdesen për detajet praktike.*
- *Nxënësit interpretojnë në skenë novelat e Migjenit (të dramatizuara).*

Përshkrimi i produktit të projektit:

Produkti final do të jetë një shfaqje teatrale e dramatizuar e novelave (mund të jetë edhe një novelë) të Migjenit, e cila do të realizohet përpara klasës, prindërve dhe/ ose komunitetit. Nxënësit angazhohen në çdo fazë të projektit, nga shkrimi i skenarit deri te interpretimi i rolit.

Vlerësimi i nxënësve:

- Vlerësimi i cilësisë së teksteve dramatike të shkruara nga nxënësit.
- Vlerësimi i bashkëpunimit dhe i kontributit individual në grup.
- Vlerësimi i aftësive të interpretimit të nxënësve.

Kriteret e vlerësimit të projekteve kurrikulare për nxënësit në AMU dhe AML

Model instrument i vlerësimit të projektit kurrikular

Kriteret për vlerësimin e projektit kurrikular vjetor				
Gjithsej 40 pikë				
Kriteret e vlerësimit	Niveli 1 – Dobët	Niveli 2 – Mjaftueshëm	Niveli 3 – Mirë	Niveli 4 – Shumë mirë
Aftësitë kërkimore/hulumtuese. Demonstrimi i tyre (12 pikë)	0-2 pikë Nxënësit rrallëherë përqendrohen te detyra e tyre. Ata mbledhin informacione pa gjetur zgjidhje të përshtatshme.	3-6 pikë Nxënësit dalin jashtë temës dhe nuk përqendrohen vetëm te detyra e tyre. Ata mbledhin informacion dhe gjejnë zgjidhje me ndihmë.	7-9 pikë Nxënësit përqendrohen te detyra e tyre shumicën e kohës. Ara mbledhin informacion dhe gjejnë zgjidhje standarde.	10-12 pikë Nxënësit përqendrohen te detyra e tyre. Ata orientohen dhe vetëdrejtohen shumë mirë. Nxënësit mbledhin informacion në mënyrë aktive dhe komentojnë për të zgjidhur probleme.
	Nxënësit përdorin një burim për të gjetur informacione.	Nxënësit përdorin të paktën dy burime të ndryshme për të gjetur informacione.	Nxënësit përdorin të paktën dy burime të ndryshme për të gjetur informacione.	Nxënësit përdorin të shumëllojshmëri informacionesh.
Analiza dhe interpretimi i të dhënave, fakteve, ngjarjeve etj. Zgjedhja dhe zbatimi i teknikave të përshtatshme (10 pikë)	0-2 pikë Nxënësit rrallëherë përdorin teknika të përshtatshme.	3-5 pikë Nxënësit ndonjëherë përdorin teknika të përshtatshme, por jo në mënyrë të vazhdueshme.	6-8 pikë Nxënësit zakonisht përdorin teknika të përshtatshme dhe efektive.	9-10 pikë Nxënësit përdorin gjatë gjithë projektit teknika të përshtatshme dhe efektive.
	Analiza, interpretimi, zgjidhja përmban shumë gabime.	Analiza, interpretimi, zgjidhja	Analiza, interpretimi, zgjidhja përmban pak gabime.	Analiza, interpretimi, zgjidhja nuk përmban gabime.

		<i>përmban disa gabime të rëndësishme.</i>		
Aftësitë e prezantimit: Prezanton në mënyrë efektive rezultatet e projektit (18 pikë)	0-5 pikë <i>Në prezantimin e nxënësve materiali është i çorganizuar dhe rrëmujë. Është e vështirë të kuptosh cilat informacione shkojnë me njëri -tjetrin.</i> <i>Prezantohen shumë pak rezultate të projektit.</i>	6 -9 pikë <i>Në prezantimin e tyre, nxënësit organizojnë mirë punën e tyre. Prezantimi jo gjithmonë të krijon lehtësi dëgjimi dhe të kuptuari.</i> <i>Prezantohen vetëm disa rezultate të projektit.</i>	10-14 pikë <i>Në prezantimin e tyre nxënësit organizojnë mirë punën e tyre që në shumicën e kohës të krijon lehtësi leximi, dëgjimi dhe të kuptuari.</i> <i>Në përgjithësi prezantohen rezultatet e projektit.</i>	15-18 pikë <i>Në prezantimin e tyre, nxënësit organizojnë shumë mirë punën e tyre që të krijon lehtësi leximi, dëgjimi dhe të kuptuari.</i> <i>Rezultatet e projektit prezantohen qartë.</i>



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Rruga "Naim Frashëri"

Nr. 37

Tiranë

Shqipëri

www.ascap.edu.al

sekretaria@ascap.edu.al

